# DËSHMI ARKIVI

**A-453480**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Amerika të ndërhyjë menjëherë, rrezikohet siguria”, ish-ambasadori: Gjykata e Hagës po na trajton si plaçkë tregu |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/amerika-te-nderhyje-menjehere-rrezikohet-siguria-ish-ambasadori-gjykata-i104741` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 20:20:44 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 20:13:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c8a4ec69cf0584a5c31b4931e9bd3eb6e842d7c761846fdf256d4118e7332a78` |
| TEKSTI | `899ec53dc5558e899edfc196d6755aa65a675c0647fc6ccffe8bab444922c334` |
| PAMJA | `18a5b6c95942336b617cac55580a59d54e58b727b4bec5eff616b74f04b218db` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3d3503ce6297a09049161765c03beaff271122a76659b92f9c2c07cc69fe01ff` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3b121f0f38f9983afad61fe399871208f196860b9a8965bfd896e6b91a545c4e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3d3503ce6297a09049161765c03beaff271122a76659b92f9c2c07cc69fe01ff`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# “Amerika të ndërhyjë menjëherë, rrezikohet siguria”, ish-ambasadori: Gjykata e Hagës po na trajton si plaçkë tregu

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 22:13



“Gjëja shqiptare në rajon është kthyer në plaçkë tregu për fuqitë e mëdha siç ka qenë në ‘13, siç ka qenë gjatë gjithë historisë së popullit shqiptar”. Kështu u shpreh në Off the Record ish-ambasadori Roland Bimo, një ditë pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së në Hagë.

Duke e cilësuar precedent të rrezikshëm për sigurinë e Ballkanit, ai apeloi që Kosova të ndërmarrë hapa urgjentë për të dalë nga kjo situatë.

“Qeveria e Kosovës të ndërmarrë urgjentisht hapa për zhbërjen e gjykatës dhe brenda mundësive në qoftë se e shikojnë nga ana kushtetuese, nëse presidenti, presidentja kushdo që të jetë i Kosovës ka të drejtën e faljes, për të dalë nga ngërçi politik që është krijuar, sepse është krijuar një situatë jashtëzakonisht e rëndë për çështjet e sigurisë dhe të stabilitetit të Ballkanit”, u shpreh ish-ambasadori në A2 CNN.

Sipas ambasadorit, me vendimin e Hagës, Europa për të shlyer njollën e zezë të turpit që është krijuar në territorin e saj nga gjenocidi serb, mundohet të krijojë një ekuivalent moral duke fajësuar shqiptarët që t'i drejtohet opinionit të vet të brendshëm dhe të thotë që çfarë mund të bëja unë me serbët, kur fajin e kishin shqiptarët.

“Është krijuar një situatë jashtëzakonisht e rëndë për çështjet e sigurisë dhe të stabilitetit të Ballkanit, për të cilët Europa për të shlyer njollën e zezë të turpit që është krijuar në territorin e saj nga gjenocidi serb, mundohet të krijojë një ekuivalent moral duke fajësuar shqiptarët në mënyrë që t'i drejtohet opinionit të vet të brendshëm dhe të thotë që çfarë mund të bëja unë me serbët kur fajin e kishin shqiptarët. Pra, në narrativën europiane kjo që ka ndodhur është jashtëzakonisht e rrezikshme dhe për këtë gjë ka paralajmëruar dhe Andrewu Josef në 5 korrik të këtij viti, kur thotë që gradualisht po fryhet një situatë ku me dashje apo pa dashje, me vullnet apo pa vullnet, gjykata do t'i dënojë këta njerëz, sepse janë harxhuar 500-600 milionë euro për të justifikuar një investim.

Jo vetëm paratë por dhe një investim moral dhe politik të Europës, e cila parathotë një destabilizim të mëtejshëm të Ballkanit duke duke inkurajuar serbët e Serbisë me në krye zotërinë që është sot president, por edhe ata që janë në Republika Serbska për të thënë që ne mund të bëjmë çfarë të duam dhe në fund të ditës europianët do ngrenë një gjykatë, e cila do dënojë viktimat tona, nuk do na dënojë neve. Precedenti është jashtëzakonisht i rëndësishëm, i rrezikshëm jo vetëm nga ana juridike, por në radhë të parë nga ana politike”, theksoi Bimo.

Në këto kushte ish-ambasadori Bimo, ka kërkuar një angazhim më të madh politik nga Shtetet e Bashkuara lidhur me zhvillimet në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, siç ka bërë edhe në raste të tjera kur kanë ngritur shqetësime për Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Po kështu duhet të evprojë edhe faktori shqiptar në rajon e botë.

“Ajo që sugjerohet është që duhen ndërmarrë hapa të shpejtë, të jashtëzakonshëm politik. Kush ka mundësi të ndikojë në administratën amerikane përmes lobimeve apo përmes ë influencave të caktuara? Sepse për sa kohë kjo gjykatë ka treguar që nuk është një gjykatë e juridike, por është një gjykatë tërësisht e ndikuar politikisht, atëherë do duhet që në këtë këndvështrim Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu sikurse kanë treguar që nuk kanë hezituar asnjëherë të shprehin dyshimet e tyre për paanshmërinë e Gjykatës Ndërkombëtare, të cilën në të gjitha rastet e shprehin ndryshimin e tyre për aftësinë e kësaj gjykate për të gjykuar krimet.

Në rastin konkret do duhet që të bëjnë të njëjtën gjë edhe me këtë lloj gjykate, por në këndvështrimin që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë angazhime kudo në botë, do të duhet që faktori shqiptar, ata që janë atje në Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo dhe shtetet shqiptare dhe atë kush ka mundësi dhe besoj që ne kemi jashtëzakonisht shumë në dorë për të qenë faktor stabiliteti siç kemi qenë deri tani, por jo që të jemi plaçke tregu siç po na trajton vendimi i kësaj gjykate”.

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 17 Shtator22:07

### [Pagat e gjyqtarëve/ Pak para votimit të draftit, Rama mbërrin në Kuvend]

Seanca plenare e Kuvendit vijon prej orës 10:00 të paradites, në një diskutim maratonë ku në rendin e ditës është e...

POLITIKE 17 Shtator22:07

**[‘Gjykatë politike’/ Bushati: Rama kur mori helikopterin e dinte se po i bëhej koncension Rusisë dhe Serbisë]**

Analisti Andi Bushati ka komentuar ashpër procesin ndaj ish-krerëve të UÇK-së dhe vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë...

POLITIKE 17 Shtator22:04

**[“Biden e dinte, por unë zgjodha gjykatën”, Berisha zbulon si u rikthye në SHBA]**

Pas disa vitesh jashtë Shteteve të Bashkuara, Sali Berisha ka rrëfyer në “Opinion” përpjekjet që, sipas tij, çu...

POLITIKE 17 Shtator21:45

**[“I djeg kësula”, Berisha vë Ramën në qendër të debatit për UÇK-në]**

Në nisje të emisionit të sotëm të “Opinion”, kryedemokrati Sali Berisha u ndal te çështja më e diskutuar e...

POLITIKE 17 Shtator21:40

**[Pagat e magjistratëve/ Bardhi: Drafti i PS, “puç kushtetues”! Shkel vendimin e Kushtetueses, vota jonë kundër]**

Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, kundërshtoi në Kuvend projektligjin e PS-së për pagat e magjistratëve, du...

POLITIKE 17 Shtator20:42

**[Vijojnë dëgjesat, Divjaka kundër Territoriales: Nuk pranojmë shkrirjen e bashkisë]**

Dëgjesa e radhës publike në kuadër të reformës administrative për Komisionin e Këshillit Bashkiak Divjakë ësht...

POLITIKE 17 Shtator20:35

**[110 ditë revoltë, protestuesit marshojnë drejt komisariatit 1: Lironi çunat]**

Kanë përfunduar fjalimet te Kryeministria. Protestuesit kanë nisur marshimin drejt komisariatit nr 1. Pasi në këtë komisariat mb...

POLITIKE 17 Shtator20:24

**[Dhuna policore, aktivisti: Të qëndrojmë bashkë, nga sot më shumë vepra dhe më pak fjalë!]**

Aktivisti Edison Lika mbajti fjalën e tij në protestën e 110-të para kryeministrisë. Ai u shpreh se kjo protestë ka qenë paq&...

POLITIKE 17 Shtator20:03

**[Korreshi ironizon qeverinë: Fshati akoma te parmenda, ju na tregoni inteligjencën artificiale]**

Deputeti i Partisë Demokratike, Saimir Korreshi, ka ironizuar Qeverinë, në lidhje me përhapjen e inteligjencës artificiale në inst...

POLITIKE 17 Shtator20:03

**[Bardhi denoncon: Kompania që u kap me 41 kg kokainë, përfitoi nga Qeveria 1 milion euro nga fondet e IPARD]**

Kreu i Grupit Parlamentar të PD, Gazment Bardhi ka denoncuar një skandal gjatë fjalës së tij ne seancën e Kuvendit. Sipas tij, ko...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

**[Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...]**

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

**[VIDEO- Dy aksidente me pesë viktima/ Prezantues...]**

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

POLITIKE 17 Shtator

**[Tensionet te ministria e Brendshme, shoqërohet ...]**

Vijojnë tensionet para Ministrisë së Brendshme. Një grup protestuesit kanë hedhur letra higjienike në drejtim të policis&e...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

**[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues]**

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

## video



## E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.